

Rovena MIKELI (VATA)

**ÇËSH TJJA SHQIPTARE NË KONFERENCËN E
AMBASADORËVE NË LONDËR (1912-1913) NË SHKRIMET
PUBLICISTIKE TË ÁT GJERGJ FISHTËS**

Abstrakt

Në aspekt të historiografisë, qoftë asaj evropiane apo shqiptare, Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) është një temë relativisht e trajtuar, ndonëse kohëve të fundit materialet dokumentare interpretohen nga këndvështrime të ndryshme e ndërdisiplinore. Në vazhden e këtij trendi rol me rëndësi paraqesin edhe kujtimet, reagimet dhe shkrimet publicistike të personaliteteve të kohës.

Fokusi i këtij punimi do të jetë përpjekja për të sjellë në vëmendje një autor të pëlqyer dhe të cituar prej secilit nga studiuesit shqiptarë, kur është fjala për çështjen shqiptare, Át Gjergj Fishtën. Kujtojmë se mbi këtë temë Át Gjergj Fishta shkruan në shkrimet e tij publicistike me tituj, si: *“Nji komedië e pandershme e XX qindvjetë”*, *“A janë t’zot shqyphtarët me u majt shtet n’vedi”*, *“Perlindja e shpirtenvet”*, etj.

Këto elemente dhe aspekte të trajtuara nga Át Gjergj Fishta, do të gjejnë shqyrtim më të hollësishëm në këtë punim, gjë që paraqet një risi në studimet historike, sepse për herë të parë paraqitet një zhvillim historik nga këndvështrimi i një intelektualit të kohës, pa paragjykime politike apo ideologjike, dhe e pa trajtuar në këtë dimension më parë. Duhet theksuar se Át Gjergj Fishta çështjen në fjalë e ka sjellë në kujtesën kombëtare, përmes shkrimeve të veta publicistike jo vetëm aspekte historike dhe ngjarje konkrete, por duke e trajtuar edhe në aspekte të tjera të ndjeshme për kombin shqiptar, duke përfshirë elementin e gjuhës shqipe apo trajtimin e fizionomisë gjeografike dhe etnologjike të Shqipërisë.

Fjalë kyçe: *Konferenca e Ambasadorëve në Londër, At Gjergj Fishta, Shqipëria.*

Gjergj Fishta njihet si një shkrimtar, arsimtar, etnolog, përkthyes, e mbi të gjitha si një atdhetar dhe frat françeskan që kishte marrë pjesë në proceset me rëndësi për emancipim dhe çlirim kombëtar, që nga shkëputja osmane e më gjerë.¹ I njohur me epin e tij “Lahuta e Malcis”, si një ep me diskurs patriotik, Fishta shkëlqeu, përmes talentit të tij, në satirikë, dramatikë, lirikë dhe publicistikë. Në këtë të fundit, Fishta u bë i njohur edhe për diskursin e tij politik, qoftë lokal apo ndërkombëtar, gjithsesi të ndërlidhur me çështjen kombëtare.

Ndonëse shkrimet publicistike të Fishtës lidhur me çështjen kombëtare përfshijnë një hark të gjatë kohor e historik, që nga ilirët, Rilindja e sidomos te periudha midis dy luftërave botërore, fokusi i këtij punimi do të jetë trajtimi i çështjes kombëtare në Konferencën e Londrës (1912-1913). Në këto shkrime reflektohet ndjeshmëria e lartë që kishte ai ndaj tronditjeve që mund të pësonte kombi, në çfarëdo sferë të jetës, në prag dhe pas shpalljes së Pavarësisë.² Konferenca e Londrës (1912-1913), si një derivat i luftërave ballkanike, ishte një proces politik i organizuar nga fuqitë e kohës: Britania e Madhe, Austro-Hungaria, Rusia, Franca, Italia dhe Gjermania, me qëllim të zgjidhjes së problemeve territoriale pas largimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani.³

Çështja shqiptare kryesonte agjendën e problemeve që duhej zgjidhur nga Konferenca, ndërsa për këtë çështje një interesim të veçantë shprehën Austro-Hungaria, Italia dhe Rusia.⁴ Kjo çështje u trajtua në dy aspekte: lidhur me të ardhmen politike të Shqipërisë dhe caktimin e kufijve të saj. Lidhur me pikën e parë ambasadorët e Fuqive të Mëdha u pajtuan për formimin e një principate shqiptare “...

¹ Valentina Duka, *Shqiptarët në rrjedhat e shekullit XX (Tiranë: Panteon & Afërdita, 2001)*, 161.

² Mark Vuji, *Filozofia arsimore e akademikut Gjergj Fishta (Lezhë: Enti Botues Gjergj Fishta, 2007)*, 81.

³ Islam Dobra, “Disa konflikte midis Italisë, Turqisë dhe Serbisë kundër interesave shqiptare në vitet 1908-1913”, *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike* (1996), 88; *Fjalor Enciklopedik Shqiptar* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 1242.

⁴ *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi III, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007), 18.

Shqypnia kà kënë njoftë prej Pushteteve të Mdhà t'Europës në Konferencë të Londonit Shtet m'vedi, si Principat monarkike kostitucjona”,⁵ në krye të së cilës vendosën princin gjerman Uiliam Vid, i cili në mars të vitit 1914 zbarkoi në Durrës për të marr përsipër detyrën e caktuar.⁶ Në aspekt të çështjes së kufijve vendimet e Konferencës patën një epilog tragjik për kombin shqiptar. Konferenca njohu një shtet shqiptar, jashtë të cilit mbeti më tepër se gjysma e territorit dhe e popullsisë shqiptare.*

Ky proces shkaktoi një dëshpërim dhe mllef në gjithë kombin shqiptar. Një mllef i tillë reflektohet edhe nga shkrimet publicistike të Át Gjergj Fishtës, si një bashkëkohës i këtyre zhvillimeve, të botuara në revistën “Hylli i Dritës”, të cilën vetë e drejtonte. Në këto shkrime Át Fishta lufton propagandën antishqiptare, shpreh mllefin, dëshpërimin dhe ironinë ndaj politikës dhe qëndrimeve të Fuqive të Mëdha ndaj çështjes shqiptare, duke ofruar njëkohësisht argumente për padrejtësitë ndaj shqiptarëve si komb, në prag dhe gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913), sikurse shprehej: “...kjo Shqipni e jona, dul ne drite e cungume përgjysmë nga Konferenca e Londres 1913, mandej prap e copetume prej Komisionit te Kufijve”.⁷ Át Fishta sjell në kujtesë ngjarje, vende, data, personalitete historike dhe politike të kohës, të cilat ndikuan direkt apo indirekt në çështjen shqiptare, në pavarësinë e saj, në zhvillimet e politikës së brendshme dhe të jashtme dhe mbi të gjitha në çështjen e hartës politike të shtetit shqiptar.

Fillimisht Át Fishta kundërshtoi propagandën racore antishqiptare, e cila sigurisht që paraqiste një aventurë për të justifikuar dhunën kundër shqiptarëve në realizim të aspiratave territoriale të shteteve fqinje ballkanike. Në artikullin “*A janë t'zot shqiptarët me majt shtet n'vedi*”, të botuar në “*Hylli i Dritës*”, Vjeti I, nr. 2, Fishta kundërshtoi shkrimet e gazetave franceze, që bazoheshin

⁵ Gjergj Fishta, “Perlindja e shpirtenvet”, *Hylli i Dritës* 2 (1921): 52

⁶ L. S. Stavrianos, *Balkans since 1453* (London: Hurst & Company, 2000), 511.

* Territori i banuar me shumicë nga shqiptarët më 1912 shtrihj në 75-76 mijë km², me një popullsi prej rreth dy milionë shqiptarësh. Me ndarjen e kufijve në Shqipërinë politike u përfshinë 28 mijë km² apo 36% e viseve shqiptare me një popullsi prej rreth 700 000 shqiptarësh... për më tepër shih: *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2022), 184.

⁷ Gj. Fishta, “Koha e ardhme e Shqypnis”, *Hylli i Dritës* 2 (1923): 52.

në shpifjet e një politikani serb se “shqiptarët kanë bishta dhe për kah forma dallojnë nga njerëzit e civilizuar”, dhe të pretendimeve se shqiptarët nuk janë në gjendje të mbajnë shtetin e tyre e si rrjedhojë duhet t’i nënshtrohen sllavëve të Ballkanit për t’i zbutur ata.⁸

Ndonëse Át Gjergj Fishta pohon se shkrimet e gazetave franceze ndikohen nga interesat kapitaliste, ngaqë francezët nuk janë interesuar kurrë për shqiptarët, megjithatë si i përgjigjet shpifjeve të tilla në mbrojtje të racës bujare shqiptare, duke përdorur argumente shkencore të natyrës antropologjike, fiziologjike, etnologjike, linguistike etj., të vërtetuara nga shkencëtarë ndërkombëtarë. Në këtë rast ai përmend antropologun e njohur gjerman, Uirkov (Wirkov), i cili pas një varg studimesh të thella i cilëson shqiptarët si një racë e hershme fisnike kundrejt popujve tjerë ballkanikë,⁹ duke pohuar kështu se të kota ishin supozimet se shqiptarët janë racë e ulët që duhet të civilizohen nga sllavët. Këto pohime Át Fishta i mbështet edhe nga konstatimet shkencore të filologut të famshëm të Universitetit të Gracit, Gustav Majer, mbi gjuhën dhe poezinë shqipe.¹⁰

Kanuni apo ligji tradicional, në shërbim të jetës së organizuar, të mbrojtjes së jetës, nderit e pronës, është një tjetër argument që Át Fishta nxjerr në pah për t’iu kundërvënë shkrimeve antishqiptare të gazetave franceze. Kanuni i Maleve të Shqipërisë dënon çdo akt të shkeljes së nderit, të jetës dhe të pronës, pra dënon vrasjet, plaçkitjet dhe ndëshkon shkeljet e rënda. E nëse një popull ka një organizim të tillë, atëherë si mund të quhet barbar, - argumentonte Fishta.¹¹ Etiketimeve se shqiptarët vrasin, djegin, vjedhin e bëjnë punë të pandershme Át Fishta u përgjigjet se gjëra të tilla ndodhin në gjithë botën e qytetëruar, por njëkohësisht parashtron tezën e krimeve të paramenduara duke marr shembull krahasues vrasjen e mbretit dhe

⁸ Gj. Fishta, “A janë t’zot shqiptarët me u majt shtet n’vedi”, *Hylli i Dritës* 2 (1913): 36.

⁹ Fishta, “A janë t’zot shqiptarët”, 37.

¹⁰ Gj. Fishta, “A janë t’zot shqiptarët me u majt shtet n’vedi”, *Hylli i Dritës* 3 (1913): 74.

¹¹ Gj. Fishta, “A janë t’zot shqiptarët me u majt shtet n’vedi”, *Hylli i Dritës* 2 (1913): 38.

mbretëreshës serbe në Beograd më 1903,* milionat e vjedhura në Panama, aferën Drajfuz*, etj.¹²

Në kohën kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër ishte në vazhden e punimeve Fishta botoi artikullin “Nji komedië e pandershme e XX qindvjetë”, revista “Hylli i Dritës”, nr. 10, 1914, në të cilën fillimisht jep një pasqyrë se si shtetet e fuqishme të kohës: Austro-Hungaria, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Rusia e Italia, kishin marr përsipër formimin e një shteti shqiptar, me kufij që ata vetë ia caktuan, me një mbret që po ashtu i vunë në krye të këtij shteti dhe me premtimin për mbrojtjen e këtij shteti. Por, grekët dhe sllavët e Ballkanit nuk respektuan vendimet e Evropës, ata u ngujuan në tokat e shtetit shqiptar: grekët deri në Vlorë, serbët në Durrës e malazezët në Shkodër, duke parashtruar më pas pyetjen se çfarë bëri Evropa?¹³

Një pyetje të tillë Fishta i përgjigjet plot mllef, duke vënë në pah jo vetëm padrejtësitë ndaj shqiptarëve, por edhe paradokset e Fuqive të Mëdha, duke u shprehur pa dorëza: *“E po, tash, shka bani Europe per kete pune? Kurrjaa! N’ Europe nuk lehi nji qen pse nji grusht Slav e Grek e kishin perbuze gjygin e popujve maa t’forte e maa gjytetnuen t’rrokullies s’kesaje bote, e se kishin poshtnue tagrin e t’drejtat e nji komit, t’cillin ajo kishte marrë me ndore n’sÿy t’anmiqve t’tii. Europa, n’vënd qi me ngÿshtue Slavt e Grekt me dalë prejë Shqypniet e mos me i lânë mâa teper me i zhÿe duert n’gjak t’Shqyptarve, (t’cillt i kishte marrë nen strehë e proje t’vet), ajo neper fletore, perkohshme e akademië t’veta rrite tujë pvetë: kush jânë Shqyptarët? a lejnë me bisht e paa bisht? a i hanë gjinden pjekë e paa pjekë? fjala qi flet i ligшти e i pandershmi, qi s’din se shka âsht*

* Më 11 qershor 1903, konspiratorët ushtarakë serbë kryen një atentat ndaj mbretit Aleksandër dhe mbretëreshës Draga... për më tepër shih: Nicholas J. Miller, “R.W Seton-Watson and Serbia during the reemergence of Yugoslavia, 1903-1914”, *Canadian Review of Studies in Nationalism* XV/1-2 (1988): 60.

* Skandali në Panama - aferë korrupsioni më 1892 ku ishin të përfshirë parlamentarët francezë; Afera Drajfuz: ushtarakë francezë që shitën sekrete ushtarake më 1894, qasur më: 15 janar 2024

<https://www.britannica.com/event/Panama-Scandal> dhe

<https://www.britannica.com/event/Dreyfus-affair>.

¹² Gj. Fishta, “A janë t’zot shqyptarët me u majt shtet n’vedi”, *Hylli i Dritës* 2 (1913): 39.

¹³ Gj. Fishta, “Nji komedië e pandershme e XX qindvjetë”, *Hylli i Dritës* 10 (1914), 298; Gj. Fishta, “Lajme-Rrokull Shqypniës”, *Hylli i Dritës* 2 (1913), 71.

*burrnia, kuur shef t'pafajin tuj gjimue nën thëmer t'maa t'fortit e per t'cillin aj t'a keet ndoj detyrë me i nimue.”*¹⁴

Në këtë aspekt Át Fishta pasqyron jo vendosmërinë dhe politikën dyfytërshe të Fuqive të Mëdha për të imponuar vendimet që vetë i kishin marr lidhur me Shqipërinë, duke e trajtuar një komedi të hidhur rastin e pushtimit malazet të Shkodrës, kur një shtet i vogël tallej me admiralët e ushtrive të fuqishme evropiane duke hedhur njëkohësisht dyshime në sinqeritetin për të detyruar malazetët të largoheshin nga Shkodra.¹⁵

Një qëndrim i tillë i fuqive, të cilën Át Fishta e konsideron si “pabesi e Evropës”, përsëritet edhe në viset jugore të Shqipërisë. Pavarësisht se Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve, kishte vendosur që Korça, Gjirokastra, Libohova etj., t'i mbeteshin Shqipërisë, ushtria greke, njëjtë sikur ajo malazeze në Shkodër, hezitonte t'i lironte këto vise dhe të largohej nga Shqipëria. “*Por, jo; ushtria greke, edhe mas t'caktuemit t'kufijve, nuk desht me dalë prejë Shqypniet. E shka bâni Europa per ket pûnë? Eurpoa vetë i dha vade nji herë me ndejë mrëndë nji muej, masandej dy, masandej deer n'kohë t'pacaktueme. E po pse Pushtetet e Mdhaa ja dhanë ket vade Grekve? shka kishin per t'bâa Grekt n'Shqypnië? Po; kishin nji pûnë t'madhe per t'bâa: me nimë t'mshefta t'do Pushteteve t'Mdha kishin per t'organizue kryengritjen e Epirotve, per me rrenue Shqypniën*”.¹⁶

Át Fishta me të drejtë hedh dyshime, nëse këto fuqi, qëllimisht toleronin një sjellje të tillë të Greqisë në mënyrë që të rrënohej Shqipëria.

Në shkrimet e tij në publicistikë Át Fishta vërteton argumentin historik se Konferenca e Londrës në seancat e saj asnjëherë nuk e pranoi si bazë parimin etnik, për zgjidhjen e çështjes së kufijve të Shqipërisë dhe vizatimit të hartës së saj etnike. “*Kuur t'mrrijnë Komisjoni me caktue kufijt e Shqypniës s'eper me Maltzii e me Serbië, dihet paa dyshim se aj s'kaa me kënë ngushtue me mârrë dragomana serbjan me vedi, per me vertetue a âsht populli serb e shqyptaar; pse kaa me gjetë qi t'gjith jânë e dishmohen Shqyptarë. E saa per fuqië e gjallnië t'shpiritit t'popullit, mjaft âsht me thânë, se nji grusht gjind i ktyne ânave, n'kohë t'kryengritjes shqyptare, kaa mrrijtë me habitë*

¹⁴ Fishta, “Nji komedië e pandershme e XX qindvjetë”, 298.

¹⁵ Po aty, 298-300.

¹⁶ Po aty, 300-301.

shekullin marë me pûnë burrniet e trîmniet. Prandej thomë, se edhe n'Shkodër, si n'ç'do tjetër gjytet t'Shqypniës, selia mretnore e qandrra e Shtetit kishin me kënë t'ngujuem m'nji themel t'fortë".¹⁷

Át Gjergj Fishta ndoshta më shumë se kushdo tjetër e kishte ndjerë dhe kuptuar hilen e vendeve të fuqishme karshi trojeve shqiptare. *"Veç shka se ky Shtet i pamvarshem, kjo Shqypni e jona duel në dritë kû e curreme e mâ se pergjymsë e krekcueme prej Konferencet të Londres në 1913 nji herë e mandej prap e gjymtueme vjet prej Komisionit të kufijvet. E vertetë qi na prej nji diplomacijet bakalle, qi me inkompetencë të veten kà shkaktue rrenimin e bankarroten e Europës marë, nuk kishim shka me pritë hajr, por kufijt e Shqypniës jânë caktue me nji dredhî djallsore fort të poshterme e të neveritne; pse, posë qi ajo na kà graditë tokët e Atdheut t'onë, na kà lanë mâ teper zjarmin e mnîs ndezë ndermjet nesh e fqivet t'onë nervoza, ke qandrat (gjytetet) e do vendeve i kan lanë m'at anë e krahinat (nahijet) ktej në ket anë, kshtû qi intrigat, të cillat, mjerisht të gjith'balkanikët, i kan zanat, s'kan me pushue kurr ndermjet nesh e tyne".¹⁸*

Át Gjergj Fishta duke qenë një dëshmitar okular i të gjitha zhvillimeve që ndodhen në vend dhe duke jetuar bashkë me shqetësimet e saj kohë e pa kohë, çështja shqiptare dhe në veçanti vendosja e kufijve të saj e kishte prekur shpirtërisht atë, si atdhetar, si qytetar, si intelektual, si politikan, si diplomat dhe si njeri. Kështu, në të njëjtën kohë, Fishta satirizon me qëndrimet paradoksale të Fuqive të Mëdha *"Kaa Shqypnie, kaa! Edhe pak dit e Mreti i jonë po vjen me xanë vend n'selit e vet; e anmiqt e Shqypnies, qi, me armë n'dore e maa fort me dredhie t'poshterme... kan me çue Ambasadorit e vet, per me pershndetë prej anës tyne Mretin e Shqypnarve",¹⁹* duke shtuar shpresën dhe argumentimin se populli shqiptar do të jetojë gjithmonë, derisa të bie dielli në tokë, dhe do t'i përballojë gjitha vështirësitë ashtu siç i ka tejkalar pushtimet e barbarëve, romakëve, sllavëve, turqve etj.²⁰ Krahas faktorit ndërkombëtar, Át Fishta në shkrimet e tij publicistike me guxim të plotë i qaset edhe faktorëve të brendshëm që u bënë pengesë për konsolidimin dhe zhvillimin e shtetit shqiptar.

¹⁷ Gj. Fishta, "Kryegjyteti i Shqypniës", *Hylli i Dritës* 4 (1914): 110.

¹⁸ Gj. Fishta, "Koha e ardhshme e Shqypnis", *Hylli i Dritës* 2 (1923), 52-53.

¹⁹ Gj. Fishta, "Koha e re n'Shqypnië", *Hylli i Dritës* 6 (1914): 169.

²⁰ Fishta, "Koha e re n'Shqypnië", 169.

Këta faktorë, që për interesa të veta personale anashkaluan ato kombëtare, u shfrytëzuan nga shtetet e fuqishme apo ato ballkanike që akoma nuk i kishin realizuar pretendimet e plota territoriale në Ballkan.

Në këtë kontekst At Gjergj Fishta e trajton figurën e Esat Pashë Toptanit. Në ballafaqimet e ashpra midis Austro-Hungarisë e Rusisë për qytetet shqiptare, qyteti i Shkodrës ishte shndërruar në pikën qendrore të debatit për kufijtë veriorë. “Austro-Hungaria këmbëngulte që ajo, për një varg motivesh dhe argumentesh, t’i lihej Shqipërisë”.²¹ “Këmbëngulja austro-hungareze bëri që Konferenca të vendoste që Shkodra t’i mbetej Shqipërisë”.²²

Por, ushtritë malazeze kishin pushtuar ndërkohë Shkodrën. Fishta e akuzonte Esat Pashë Toptanin për dorëzimin e Shkodrës tek malazezët.

*“Esad Pasha si i pari i shpiës s’Toptajve, pat shtrii, sikur se dihet, doren e vet kahë kunora e Shqypniës, t’cilen mân lej, ju desht prejë shterngimit porsi kryepaar i deputacionit shqyptaar, qi ishte, ma ja paraqitë Princit de Wied. Esad Pasha si general ushtriet turke pat lshue Shkodren malazezve. T’marredhanunt e tii per t’lshuem t’Shkodres me general Martinoviqin, mas deket t’vleritit komandaar Hasan Rizaas, nuk shkephsin kerkûnd njeti, veç n’t’njoftun t’Pashës per princ Shqypniet. E per me mueit me dalë lirisht prejë Shkodret me pushkë e topa, ju desht me dhânë fjalen se do t’mërrte pjesë n’lidhje t’Balkanit”.*²³

Esat Pashë Toptani trajtohet nga Fishta si figurë kryesore në vënien e barrierave ndaj konsolidimit dhe zhvillimi të shtetit shqiptar, i cili ishte burgosur dhe akuzuar për komplot kundër princit Vid.²⁴

“Esat Beg Toptani, i paditun për trathtie e komit e per trillime kundra dinastiet t’Wied, kje xane prej Mreit t’Shqypnies.... por Evropa, e cila vete e kishte pruu Mretin n’Shqypnie, nuk la me u ba ky gjyygj mii Esat Beg Toptanit. Italia e muer Esatin ndore, edhe paa i dhanë kujë arsye per ket pune, e çoj me gzue veren m’breg t’detit

²¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, 191-192.

²² Përparim Rexhepi, *Mbrojtja e Shkodrës 1912-1913* (Tiranë: Globus R, 2001), 151.

²³ Gj. Fishta, “*Lajme-Rrokull Shqypniës*”, Hylli i Dritës 9 (1914): 294-295.

²⁴ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, Vëllimi I, 238.

*t’Napolit, tuje poshtnue n’ket mdnyrë para botës mare fjalën e Mretit t’Shqypnisë Vilhelmit I”.*²⁵

Rebelimi kundër Vidit kishte pezmatuar Fishtë. Ai i akuzonte për komplot edhe ata që e kishin caktuar Vidin për princ të Shqipërisë. *“Marre e turp per Europë! Por Europa nuk din sod se shka është marrja, ndera e burrnia. E po O’farë nderet e burrniat mundet me pasë sod Europa, ajo qi tash një m’uej kaa çue n’lymâa t’Durrësit donamet e veta e qi Admiralt e sajë, me duer m’nie e paa farë kujdesit, rriin tujë kqyrë kahë Shqyptarët grîhen vllaa me vllaa, e kahë Mreti Vilhelmi I. - ndorja e tyne, - orvatet me pshtue gjallë me krye prejë kryengrîtsve? Po, po; donamet e gjashtë Pushteteve t’Mdhâa tash një muej, t’thuesh, gjinden n’Durrëc kinsëme i dalë zot Mretit, e enë kurrnjâna nder to s’e kaa shprazë me thânë një fyshek per Mretin; pse Aliotat, Morrchinat, Kinigohat e Europës rriin tujë bertitë se Pushtetet e Mdhâa do t’rriin dorjashtë n’ket levizje t’Shqypniës. E para kujë o Zot, do t’rriin dorjashtë, neutral Pushtetet e Mdhâa? Para kryengrîtsve, para koçakve, qi n’zêmer t’mretniës s’Shqypniës, prejë seliet mretnore t’Shqypniës Vilhelmin Wied, t’cillin vetë Pushtetet e Mdhâa e kan vûu Mret n’Shqypnië. Ah! po, kta dishmon qi Europa është teper e raame e e poshtnueme, e se diplomacia europiane është vetë faqja e zezë e marrja e turpi i t’gjith nierzimit”.*²⁶

Trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës në publicistikën e Gjergj Fishtës, tregon brengën e tij për copëtimin e tokave shqiptare. Në këto shkrime Gjergj Fishta shpreh mllëfin, por edhe ironizon Evropën në përgjithësi dhe Fuqitë e Mëdha në veçanti, të cilat u treguan të padrejta në vizatimin e hartës së Shqipërisë së njohur, siç shprehej Fishta, edhe prej vendeve të qytetëruara. Po ashtu ai shprehte zemërimin, pavendosmërinë dhe politikën dyfytyrëshe të shteteve të mëdha të cilat nuk ishin në gjendje të mbronin apo zbatonin obligimet e tyre ndërkombëtare karshi shtetit shqiptar shqiptare.

Trajtimi i çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës për copëzimin e trojeve shqiptare nxjerr edhe një tjetër aspekt në shkrimet publicistike të Gjergj Fishtës, pikërisht një anë tjetër të shqiptarit, atij të ligut, hajdutit, të paditurit dhe “shitësit” të trojeve shqiptare. Fishta nuk ngurron t’u drejtohej me emra të gjithë atyre që kishin marr pjesë

²⁵ Fishta, “Nji komedië e pandershme e XX qindvjetë”, 302.

²⁶ Po aty, 303.

kundër kombit shqiptar, të cilët bënin gjithçka për të qenë sundimtar të tokave shqiptare.

Duke trajtuar rolin e Esat Pashës, Fishta nga ana tjetër tregon në këto shkrime se rreziku që vinte prej vetë shqiptarëve ishte më i egër sesa ai që vinte prej të huajve, teksa shkruante se shqiptarët janë armiqtë e vetvetes dhe për sa kohë nuk mund të krijojmë një shtresë të lartë intelektualësh, të cilët punojnë vetëm për interesat e kombit dhe jo për interesat e tyre personale, familjare dhe miqësore, nuk do të arrijmë drejt një përparimit, zhvillimit, qytetërimit, civilizimit. Mund të themi se në këto shkrime Fishta tregon largpamësi, analizë dhe guxim, që të shkruaj në mënyrë të drejtë e pa paragjykime, pavarësisht rreziqeve sidomos nëse merren parasysh rrethanat e kohës.